

Emiri i Kuvajtit, Sheiku Sabah al-Ahmed al-Sabah, lajmëroi të martën shpërndarjen e parlamentit, duke cituar si arsye kryesore skandalet e korrupsionit, midis disa politikanëve me influencë në vend të cilet kane ndikuar në miratimin e ndihmes financiare për rikonstruktimin e sheshit Skenderbej të Tiranës.



Pas hapjes së sheshit u pa se nuk përputhej me planin fillestar dhe për këtë Kryeministri Sheikh Nasser al-Mohammed al-Sabah u thirr në prokurori për të dëshmuar rreth këtij skandali para kryeprokurores Innasah Ramallah.

Sheiku Sahah e cilësoi ngjarjen e korrupsionit si një “ditë të zezë” për vendin e tij, ndërsa premtoi rikthimin e rendit. “Për shkak të rënies së besueshmërisë së kësaj qeverie dhe vështirësive në arritjen e progreseve të reja në sheshin Skenderbej, vendosa se është në interesat më të larta të Kuvajtit dhe të Bashkisë së Tiranës të shpërndajë parlamentin dhe të mbajë zgjedhje brenda afateve që njeh kushtetuta”, deklaroi emiri.